

RRËFIM EKSKLUZIV/ “Humba një mik!”, Neritan Ceka për ndarjen nga jeta të Kryepeshkopit Anastas: Ishte njeriu që pa nga e ardhmja! La pas një Sinod tërësisht shqiptar



Në emisionin “Kjo Javë”, të gazetares Nisida Tufa në News24, ishte i ftuar ish-deputeti Neritan Ceka, i cili u ndal tek ndarja nga jeta e Kryepeshkopit Anastas dhe punën e bërë gjatë jetës së tij.

Ai u shpreh se me Kryepeshkopin kishte një marrëdhënie miqësore, ndërsa ka vlerësuar punën e bërë nga ai në ngritjen e Kishës Ortodokse Shqiptare.

Ceka ka shtuar se pavarësisht perceptimit të opinionit publik në fillimet e ardhjes së tij në Shqipëri, qytetarët e deshën shumë dhe kjo u vërtetua edhe me ndjesinë e krijuar në publik në momentin që u mor vesh sëmundja e Fortlumturisë së Tij.

“Humba një mik! Mendoj që edhe Shqipëria përtej asaj që shfaqet ka dhënë disa mesazhe të singerta ndaj njeriu i cili e meritonte vërtetë, jo në momentin e fundit të ceremonisë, por mënyrën se si u zhvillua, ankthi që kishin njerëzit për sëmundjen, përpjekjet për të zgjatur jetën, tregonte jo vetëm dhimbje por edhe rezultat i një simpatie të gjatë të njerëzve për të.

Me Anastasin u njoha që në 1991 kur erdhi, por edhe më shumë në 1992 kur nisi odisea e tij në përballjen me opinionin. Ishte njeriu që pa nga e ardhmja. Në kontaktet e para që pata, në atë kohë isha në politikë.

Në 1994 kur u bë objekt i Kushtetutës, një nen ishte i lidhur me Kryepeshkopin, që e penalizonte sepse kërkonte që krerët e komuniteteve të ishin me gjak shqiptar, ne i dhamë një mbështetje.

Nga bisedat me të kujtoj një pritje në Hotel Dajti, më pyeti si e mendon, cili do të jetë rezultat? I thash nuk është puna si do të votohet, por është një çështje për të kuptuar misionin e fesë në tërësi. Çështja e shtruar është ekziston apo jo Zoti. U trondit dhe iu duke si blasfemi. Që aty nisi një miqësi. Në 1997 në Elbasan isha kandidat dhe e takova, jo për t'i marrë mbështetje, pasi në linjën time mendoj që politika e feja janë gjera të cilat nuk duhet të bashkohen kurrë.

Unë vetë jam bektashi, nuk u shpreh menjëherë, më tha se si e mendoja në përgjithësi, më përcolli dhe më bekoj kur po largohesha, dhe fitova.

Ishte sintezë e gjërave më të vlefshme që shohim tek njeriu, qoftë përgatitjen intelektual edhe qetësinë”, tha ai.

Neritan Ceka foli edhe në lidhje me trashëgiminë që la Kryepeshkopi Anastas, ndërsa duke u ndalur tek kundërshtitë që kishte për figurën e tij kur sapo erdhi në Shqipëri, ai u shpreh se nëse Fortlumturia e Tij do të kishte si qëllim ndërtimin e një kishe greke, kishte të gjithë mundësinë që ta bënte një gjë të tillë, por zgjodhi të mos ta bënte.

“La pas një Sinod tërësisht shqiptar. Janë të gjithë intelektualë, figura që vijnë nga një përgatitje e gjatë, që kanë bërë shkolla, jo nga improvizime.

Në këtë kuptim, merita e madhe e kryepeshkopit ndërtoi një godinë kaq të fortë sa nuk shembet më”, tha ai.

balkanweb.com